



Aplikoni për mbështetje nga RCF

Fondi Rajonal i Sfidave

Fondi Rajonal i Sfidave (RCF) ofron një avantazh konkurrues për bizneset pjesëmarrëse në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor.

Bizneset kanë nevojë për punëtorë të aftë. Për këtë arsye, të rinjtë duhet të zhvillojnë aftësitë e duhura. RCF lidh ndërmarrjet që kanë nevojë për fuqi punëtore të kualifikuar me institutet e formimit profesional (VTI) të cilat përdorin një qasje unike për trajnimet bashkëpunuese. Kjo qasje është më efektive sesa arsimi dhe trajnimi profesional tradicional (VET).

Nëpërmjet RCF-së, VTI-të krijojnë partneritet me ndërmarrjet për të personalizuar programet e trajnimit bashkëpunues dhe studentët mësojnë aftësitë e nevojshme për biznesin tuaj. RCF-ja do të financojë investime në pajisjet dhe infrastrukturën që u nevojiten VTI-ve për të ndihmuar studentët të zhvillojnë këto aftësi. Rezultati do të jetë punëtorë të mirë-trajnuar që janë të gatshëm të punojnë për ju.

Përfitimet e Trajnimit Bashkëpunues për Bizneset

- ✓ Rrit produktivitetin, konkurrencën dhe inovacionin e bizneseve pjesëmarrëse.
- ✓ Studentët - punëtorët e tyre të ardhshëm - fitojnë aftësitë e duhura sepse ata mësojnë si në mjediset arsimore, ashtu edhe në trajnimin në vendin e punës.
- ✓ Ul kostot e rekrutimit dhe trajnimit pas fillimit të punës.

Përfitimet e RCF-së për Bizneset

- ✓ Pajis VTI-të me pajisjet që u nevojiten për të trajnuar në lidhje me aftësitë që nevojiten sot.
- ✓ E bën më të lehtë për biznesin tuaj që të bashkëpunojë me VTI-në e duhur për të ndërtuar një program trajnimi që u përshtatet nevojave tuaja.

Kush mund të aplikojë për mbështetjen e RCF-së

Konsorciumet e instituteve të arsimit profesional dhe bizneseve që kanë nevojë për fuqi punëtore janë të mirëpritur të aplikojnë.

Një konsorcium duhet të përfshijë:

- ✓ Një institut të formimit profesional publik ose privat të licencuar zyrtarisht, si shkolla apo qendra trajnimi VET, nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor që dëshirojnë të angazhohen në aktivitete trajnimi bashkëpunues
- ✓ të paktën 2 ndërmarrje partnere

Grantet e RCF-së do t'u jepen VTI-ve si partnerë kryesorë të një konsorciumi për trajnim bashkëpunues.

Projektet që mbështeten nga RCF

Projekte që fokusohen tek krijimi ose përmirësimi i trajnimeve të tilla bashkëpunuese. Konsorciumet mund të aplikojnë për fonde për blerjen e pajisjeve e makinerive, për investime në ndërtim dhe rinovim, për përmirësim të kurrikulës dhe materialeve të trajnimit apo për trajnimin e mësuesve ose vetë trajnuesve brenda ndërmarrjes, duke synuar forcimin e aspekteve praktike të programeve të trajnimit.

Shuma e granteve do të variojë nga 150.000 deri në 600.000 Euro.



Si mund të aplikoni

Konsorciumet e interesuara mund të dorëzojnë elektronikisht një Shprehje Interesi e cila do të vlerësohet nga komiteti i përzgjedhjes, i përbërë nga ekspertë ndërkombëtarë të VET. Konsorciumet e përzgjedhura do të ftohen të paraqesin propozime të plota për projektet.

Mëso më shumë!

Vizito faqen www.rcf-wb6.org për të mësuar më shumë rreth thirrjeve të hapura, kritereve të pranimit, procesit të aplikimeve dhe eventeve të ardhshme.



Na ndiqni



Partnerët e implementimit

